

Gjendjet Shëndetsore te Personat e Moshës së Rritur



Dermatitisi Ngacmues i Dorës (Ekzema)

Njoftime Të Rëndësishme

- Mbani mend se uji, si element i vetëm, mund të ndikoj si mjet ngacmues
- Larjen e plaçkave në dorë duhet ta minimalizoni
- Largohuni kontakteve direkte të lëkurës me sapun, detergjent, shampoon dhe mjete tjera ngacmuese
- Nëse punoni me ujë dhe ngacmues të tjerë të lëkurës, në vend se të përdorni vetëm dorëza gome më mirë përdorni dorëza me astar të pambukët
- Përdorni krema njomëse, sikur 'sorbeline' ose krema ujëse ose shpesh mund të përdorni melhem emulsiv
- Përdorni krema njomëse sidomos pasi ti lani duart
- Kremat kortizon dhe kremat 'melhem' të dhëna me udhëzim mjeku duhet përdorë vetëm nëse ekzema është prezente

Ç'është Dermatitis?

Dermatitis (ekzema) është pezmatim që shkakton skuqjen e lëkurës, bën lëkurën me luspa dhe shkakton kruarje të madhe. Në lëkurë me ngjyrë, pezmatimi shprehet më shumë me ngjyrë të purpurët se sa të kuqe ose ngjyrën e lëkurës e bën më të mbyllët.

Ku zhvillohet?

Kur zhvillohet në dorë, mund të paraqitet edhe me flluska të imta që shtrihen përgjatë pjesëve anësore të gishtave ose në pëllëmbë. Duart mund të nisin të bëhen të thatë dhe të dhëmbin me plasaritjen dhe pëlcitjen e lëkurës në pëllëmbë ose rreth gishtërinjëve.

Çka shkakton sëmundjen?

Lagështia dhe terja konstante e duarve, plus kontakti i shpeshët me sapuna, detergjente dhe ngacmues të tjerë gjatë kohës së kujdesjes së foshnjëve mund të ngacmojnë duart. Nëse një person veç ka tendencë të zhvillimit të dermatisit, mundësitë janë më të mëdha që kësaj rradhe dermatisi të paraqitet në duar. Kohë pas kohe, dermatisin në duar mund ta shkaktoj një alergji e vërtetë që personi mund ta ketë ndaj ndonjë kemikalje që përdorë. Por pjesa dërmuese e dermatisit që sulmon duart nuk ka të bëjë me alergji.

Molisja, lodhja dhe stresi e keqësojnë gjendjen e ekzemës. Krumja e lëkurës mund ta shkaktoj çarrëjen e lëkurës dhe dermatisi mund të bëhet infektiv. Dermatisi në duar mund të keqësohet gjatë dimrit meqë koha e ftohët shkakton lagështi të ulët që ndikon në tharrjen e lëkurës. Kontakti me prodhime që e thajnë lëkurën sikur solventët duke përfshirë turpentinën,

Albanian – Irritant Hand Dermatitis (Eczema)

karosinën, benzina, prodhimet për mirëmbajtje shtëpiake, kopshtari dhe pregaditjet ushqimore vetëm sa shtojnë problemin e dermatisit në duar.

Si trajtohet?

Ç'ështëja kryesore për përballimin e dermatitis *it* qëndron në evitimin e gjërave që e ngacmojnë lëkurën. Pra duhet me minimizu larjen në dorë dhe kontaktet me sapun, detergjente dhe solvent ose ngacmues të tjerë. Dorëzat me astar prej pambuku PVC janë të përshtatshme për punë më të rënda. Për punë të imta mund të përdorni dorëza të pambukta nën dorëza gome. Nëse mbani vetëm dorëzat e gomës , ato mundë ta ngacmojnë lëkurën, meqë shkaktojnë djerësitjen e lëkurës.

Meqë nën unaza mund të ngelë sapun, uj dhe kemikalje të tjera ato duhet ti hiqni para se ti lani duart me sapun ose pasi ti keni bërë punët shtëpiake. Lëkurën nën unaza duhet tharë me kujdes. Amoniaku në pelenat e njoma poashtu mund ta ngacmojë lëkurën. Pelenat duhet ti kapni me kapëse ose me dorëza me qëllim të evitimit të kontaktit direkt me dorë. Bile edhe vetë uji mundë të veprojnë si ngacmues duke shpërlarë vajërat mbrojtëse në lëkurë.

Në vend të sapunit mund të përdoren kremat njomëse si 'krema sorbolene' krema ujore dhe melhem emulziv. Ato duhet shpesh të përdoren në lëkurë gjatë ditës si mjete njomëse e posaqërisht duhet përdorë pas larjes. Ndërkohë që dermatitis *i* është aktiv, kremat kortizon ose melhemet të dhëna me udhëzim të mjekut do të duhen të përdoren për qetësim të pezmatimit të lëkurës. Poashtu trajtimi i çfarëdo infektimi kërkon marrje të antibiotikëve të dhëna me udhëzim mjeku.

Pasi të qetësohet dermatitis*i*, duhet ndalur përdorimin e kremave kortizon. Si preventivë kundër paraqitjes së sërishme të dermatitis *it* duhet rregullisht të përdorni krema njomëse dhe vazhdimisht duhet ti ikni mjeteve ngacmuese. Kohë pas kohe, një testim nga dermatologu mund të jetë i nevojshëm për të vlerësuar a mos po zhvillon alergji të vërtetë ndaj kemikaljeve. Nëse zhvillohet alergjia, atëherë duhet evituar kontaktet me kemikalje.

Informata Të Mëtejme

Infermijerja e juaj e Qendrës Për Shëndetin e Nënës dhe Fëmiut
Farmacistin tuaj
Mjekun e familjes
Dermatologun